REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR**

**KËSHILLI DREJTUES NË RTSH**

# NJOFTIM

**Për shpalljen e konkurimit për pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar".**

Këshilli Drejtues i RTSH në bazë të vendimit nr.16 datë 30.05.2023 shpall të hapur konkurrimin për pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar".

Kriteret e konkurrimit për Drejtor të Përgjithshëm të RTSH-së janë:

1. Këshilli Drejtues i RTSH-së shpall publikisht kriteret e konkurrimit për Drejtor të Përgjithshëm të RTSH-së, të cilat janë:

a) të jetë shtetas/e shqiptar;

b) të ketë kryer arsimin e lartë;

c) një individ me ndjenjën më të lartë të integritetit, përgjegjësisë, kualifikimeve profesionale dhe meritave;

ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 vjet, nga të cilat 5 vjet pozicione menaxhimi në media, institucione publike (jo administratë), sektori privat, në shkenca komunikimi, teknologji komunikimi dhe digjitale;

d) të ketë përvojë të spikatur në menaxhim dhe drejtim;

dh) të dëshmojë njohje të sektorit publik audioviziv, misionin dhe zhvillimin e tij në përputhje me standardet europiane.

Pranimi i kandidaturave do të bëhet brenda periudhës 10 ditore duke filluar nga 30 Maj 2023 deri në 8 Qershor 2023.

2. Kandidatët duhet të dorëzojnë në zarf të mbyllur tek Protokolli i Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së me mbishkrimin "Për Këshillin Drejtues të RTSH-së", dokumentat e mëposhtme:

a) curriculum vitae të plotë;

b) dëshmi penaliteti;

c) platformë zhvilluese për Radio Televizionin Publik Shqiptar, që përmban:

- strukturën programore dhe organizative të sistemit të RTSH-së në përmbushje të Deklaratës së Qëllimit;
- planin e menaxhimit për veprimtarinë prodhuese e financiare të këtij institucioni.

Sipas nenit 104 të ligjit nr.97/2013, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet:

a) të jetë anëtar i partive dhe shoqatave politike, kandidat për deputet apo të jetë zgjedhur i tillë gjatë 2 legjislaturave të fundit, të ketë konkurruar për kryetar të njësive vendore në zgjedhjet e fundit të organizuara për to apo kanë ushtruar detyrën e kryetarit të bashkisë, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë 3 vjetëve të fundit, si dhe ata që janë anëtarë të Këshillit të Ankesave, AKEP-it apo punonjës të këtij të fundit;

b) të jetë person i lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" ose që ka në pronësi pjesë kapitali apo aksione të shoqërive tregtare, si dhe të drejta të tjera në fushën e transmetimeve audiovizive, reklamës, prodhimeve të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, rrjeteve të komunikimit elektronik apo persona të punësuar gjatë vitit të fundit, anëtarë të organeve drejtuese apo këshilluese të këtyre subjekteve apo të lidhur me ndonjë licencë me këto subjekte.

2. Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së nuk lejohet të kryejë ndonjë detyrë, veprimtari fitimprurëse ose të jetë i lidhur në ndonjë marrëdhënie punësimi të dytë gjatë kohës që është në detyrë.